

Pyetje që Bëhen Shpesh mbi Linjën e Ndhmës për Shëndetin Mendor për Ofruesit e Shërbimeve dhe Mbështetësit

1. Çfarë është Linja e Ndhmës për Shëndetin Mendor në Massachusetts (BHHL)

Linja e Ndhmës për Shëndetin Mendor në Massachusetts (BHHL) është një pikë e vetme kontakti për individët dhe familjet që të marrin në kohë reale mbështetje, vlerësim klinik fillestar dhe lidhje me shërbimet e duhura të vlerësimit dhe trajtimit të problemeve të shëndetit mendor dhe çrregullimeve të shkaktuara nga përdorimi i substancave.

2. Si funksionon?

BHHL është e disponueshme 24 orë në ditë, 365 ditë në vit, me telefonata dhe mesazh me tekst në numrin 833-773-2445 (BHHL), si edhe me chat online në masshelpline.com. Çdo telefonatë, mesazh me tekst apo chat përfshin monitorimin klinik dhe stafi do të qëndrojë në linjë derisa të personi që ka kontaktuar të jetë lidhur me shërbimet.

3. Kur është operacionale?

BHHL u hap në 3 Janar 2023.

4. Në cilat gjuhë është e disponueshme?

BHHL ofron përkthim në kohë reale në më shumë se 200 gjuhë. Individë që janë të shurdhër apo që kanë vështirësi me dëgjimin mund të kontaktojnë MassRelay në numrin 711.

5. Sa kushton?

BHHL është falas dhe e disponueshme për të gjithë rezidentët e Massachusetts pavarësisht statusit të siguracionit apo aftësisë për të paguar.

6. Kush përgjigjet te BHHL?

BHHL është shërbim që ofrohet nga Komunuelthi i Massachusetts dhe operohet nga Partneriteti për Shëndetin Mendor në Massachusetts (MBHP). Personeli i BHHL janë specialistë mjekësorë të trajnuar dhe persona që kanë përjetuar të njëjtat probleme të certifikuar për të ofruar mbështetje për të gjitha nevojat e personave që kontaktojnë.

7. Si e përcakton BHHL rrezikun?

Personeli i BHHL është trajnuar për të kryer vlerësim të plotë të rrezikut duke përdorur instrumente vlerësimi me standardet e industrisë. Bazuar në mprehtësinë dhe seriozitetin e situatës së personit që kontakton, vlerësimet e rrezikut kategorizohen si emergjente, urgjente apo rutinë.

8. Cili është hapi i radhës për personin që kontakton?

Personeli i BHHL bën referimet në bazë të vlerësimit të rrezikut për çdo person që kontakton. Një vlerësim i rrezikut si “emergjent” rezulton në reagim nga 911 apo nga Ekipet e Lëvizshme të Ndërhijes në Kriza. Një vlerësim i rrezikut si “urgjent” mund të rezultojë në reagim nga ekipi i Kujdesit Urgjent për Shëndetin Mendor. Një vlerësim i rrezikut si “rutinë” mund të rezultojë në lidhjen me një nga 25 Qendrat Komunitare për Shëndetin Mendor (CBHC) që janë krijuar kohët e fundit apo me një ofrues tjetër kujdesi për organizimin e pacientëve jo të shtruar. Personeli i BHHL përdor edhe Aksesin në Shëndetin Mendor në Massachusetts (MABHA), 211 burime dhe instrumente të tjera ekzistuese për të ndihmuar personat që kontaktojnë të kenë akses në burimet për të cilat kanë nevojë (p.sh., transport, kujdes për fëmijët apo ushqim).

9. Çfarë është një delegim i përshtatshëm?

Kur referon një person që ka kontaktuar te një ofrues kujdesi apo burim, anëtari i personelit të BHHL do të qëndrojë në linjë me këtë person ndërkohë që e lidh me burimin apo ofruesin e radhës të kujdesit. Anëtari i personelit të BHHL do të komunikojë arsyen për kontaktin dhe informacione mbi nevojat e personit, dhe do të qëndrojë në linjë derisa të finalizohen hapat e radhës. Personeli i BHHL do të kontaktojë më vonë me personin për të siguruar që tranzicioni i kujdesit të jetë i suksesshëm.

10. Kur duhet një ofrues kujdesi apo mbështetës të referojë dikë te BHHL?

- Kur identifikojnë një nevojë “urgjente” apo “rutinë” të shëndetit mendor.
- Kur dikush ka shqetësime emocionale “jo emergjente” dhe gjykojnë që ka nevojë për vlerësime shtesë të shëndetit mendor.
- Kur dikush nuk po gjen dot shërbimin e duhur të shëndetit mendor apo nuk po përcakton dot se për çfarë trajtimi apo mbështetje ka nevojë.

11. Si punojnë 988, 211 dhe 911 me BHHL?

Ekipet e 988, 211 dhe 911 punojnë së bashku për të siguruar një delegim të përshtatshëm për te dhe nga BHHL, në përputhje me nevojat e personit që kontakton.

12. A do të ketë materiale konsumatori të disponueshme për t’u shpërndarë?

Materiale si postera, broshura dhe kartolina të palosshme do të jenë të disponueshme në 12 gjuhë nga Agjencia e Massachusetts për Mbledhjen dhe Shpërndarjen e Materialeve dhe Informacioneve mbi Shëndetin Mendor te www.mass.gov/MAClearinghouse.

Për të mësuar më shumë, vizitoni masshelpline.com.